



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
 Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
 Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Nr. 529
 Datë: 14.06.2023

Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 06/L-116 për Shoqëritë Tregtare, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Pezullohet certifikata e biznesit të kompanisë "KLAN KOSOVA SH.P. NUI 810795297, të datës 29.05.2020.
2. Ky pezullim vlen deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër.

Arsyetim

Duke u bazuar se me datën 14.06.2023 është iniciuar kallëzimi penal në Departamentin për Krime të Rënda në kuadër të Policisë së Kosovës, me pretendimin se në certifikatat e biznesit tek ndërrimi i pronarëve figuron vendbanimi Pejë- Serbia dhe Gjakovë-Serbia, meqë nuk lejohet regjistrimi i një biznesi ku vendbanimi është në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që në bazë të këtij dokumentacioni vërtetohet se qyteti i Pejës dhe Gjakovës është nën administrimin e Republikës së Serbisë, në bazë të nenit 85 të Ligjit nr. 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Pranvera Prestreshi
 Zr. Drejtore e Përgjithshme

1

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankesë në Komisionin për shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve në kuadër të Ministrisë brenda afatit prej 30 ditë nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kabineti të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Palës;
- ARBK-së;
- Arkivës.